



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**  
**REPUBLIK OF KOSOVO**



**KOMUNA E LIPJANIT**  
**OPŠTINA LIPLJAN**  
**MUNICIPALITY OF LIPJAN**

---

**DREJTORATI PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

Datë:	<b>06.01.2019</b>
References:	
Për :	<b>Z. Imri Ahmeti</b> - Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje :	<b>Z. Fauz Xhemjali</b> - Nënkyetar i Komunës <b>Z. Lulzim Qerimi</b> – Nënkyetar për Komunitete Arkiven
Nga:	Bekim Shabani - Drejtor i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport
Lënda:	<b>RAPORT -- Mujor -- Dhjetor - 2018</b>

Gjatë muajit dhjetor në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale.

Në raportimet javore e kemi paraqitur përafersisht punën e drejtoratit.

## **AKTIVITETET GJATË MUAJIT DHJETOR 2018**

- Kemi bërë raportin mujor Nëntor 2018,
- Kemi zhvilluar takim me përfaqesuesit e bashkimit European ROMACTED.
- Kemi mbajtur dëgjimin publik për rregulloren për shfrytëzimin dhe mënyrat dhe kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve sportive publike dhe fushave të hapura sportive.
- Kemi mbajtur trajnimin për rregulloren MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standartet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.
- Kemi plotësuar planin gjithëpërfshirës sipas kompetencave të drejtoratit dhe dërguar në drejtoratin për Zhvillim Ekonomik.
- Kemi bërë vlersimin e punëtoreve conform me Ligjin e Shërbimit Civil nr .03/L-149 dhe Rregullores nr .19/2012 mbi Procedurat e Vlerësimit të rezultateve të punës, dhe i njejtë është dorëzuar në zyrën e personelit.
- Është punuar në renovimin në qendren sportive si psh: në ndriqim, dyer të brendshme, në tribuna dhe pasije tjera sportive, i financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
- Ka dështuar dekorimi i sheshit “Adem Jashari” dhe qytetin e Lipjanit për festat e vundvitit 2018, është shkëputur kontrata nga AK dhe është njoftuar OE rreth shkëputjes së kontratës.
- Qendra Rinore në Magure është furnizuar me antifriz dhe njëherit është testuar nxemja.
- Është bërë përzgjedhja e sportistit të vitit dhe sportistëve të tjerë për vitin 2018, si sportist të vitit 2018 është zgjedhur Leonita Hoxha.
- Kemi punuar në raport vjetor të vitit 2018.
- Me nga një shkresë i kemi njoftuar të gjitha klubet sportive që deri më 15.01.2019 janë të obliguara të dorëzojnë arsyetimet sipas kontratave të nënshkruara mes Komunës së Lipjanit dhe klubeve sportive.
- Në Qendren, Rinore në Magurë është furnizuar edhe me 8 topa (4x basket+ 4x volejboll),si dhe 4 tabela shahu dhe 2 orë shahu.
- Më datë 27/12/2018 në qendren rinore në Magure në bashkpunim me qendren tregtare 7 Vllëzerit, kemi organizuar nje aktivitet ku janë ftuar nxënësit e ciklit parashkollorë të Shkollës fillore “Haradin Bajrami” në Magure, ku janë dhënë dhurata për femijë dhe nga një fotografi për secilin, i gjith program është i përcjellur me muzikë për femijë, si dhe shumë vjersha që kan recituar.

### **AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR-- Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër për muajin raportues.**

- Pranimi, shqyrtimi dhe arkivimi i lëndëve,
- Sektori i Arkivit është duke ju ofruar shërbime palëve sipas kërkesave të tyre,
- Biblioteka ofron shërbime konform kompetencave dhe kapacitetit të saj,
- Qendra sportive në Lipjan ka vazhduar punën sipas orarit të zakonshëm.
- Qendra Rinore në Magure është duke punuar sipas orarit.

**Në vazhdim paraqesim raportin në formën tabelare:**

**1. ZGJIDHJA E LËNDËVE NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE TË PRANUARA NGA PALËT**

**Tabela-1, -- Pasqyra totale e lëndëve të pranuar nga palët**

<b>Gjithsejt</b>	<b>Të Aprovuara</b>	<b>Të Refuzuara</b>	<b>Në Proces</b>	<b>Të Pazgjidhura</b>
<b>12</b>	<b>6</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>-</b>

**Tabela- 2, -- Kërkesa të parashtruara për Arkivin Komunal – Lipjan**

<b>Kërkesat e parashtruara</b>	<b>Të realizuara</b>	<b>Numri i dokumenteve të lëshuara(kopje nga Arkivi)</b>	<b>Në proces</b>	<b>Vërejtje : Te hyrat:</b>
<b>3</b>	<b>3</b>	<b>43</b>	<b>0</b>	<b>21.5.00€</b>

**Tabela- 3, -- Raport për Bibliotekën e Qytetit në Lipjan**

<b>Vendi</b>	<b>Libra në huazim</b>	<b>Libra të kthyera</b>	<b>Lexues te rinj</b>	<b>Përpunim i librit</b>	<b>Lexus në sallën e leximit</b>
<b>Spektori për fëmijë</b>	<b>249</b>	<b>330</b>	<b>40</b>	<b>-</b>	<b>389</b>
<b>Spektori për të rritur</b>	<b>50</b>	<b>159</b>	<b>35</b>	<b>-</b>	<b>588</b>

**Tabela- 4, -- Raport për Bibliotekën në Gadime**

<b>Libra në huazim</b>	<b>Libra të kthyera</b>	<b>Lexues te rinj</b>	<b>Përpunim I librit</b>	<b>Lexus në sallën e leximit</b>
<b>230</b>	<b>145</b>	<b>10</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**Tabela- 5, -- Raport për Bibliotekën në Shalë**

<b>Libra në huazim</b>	<b>Libra të kthyera</b>	<b>Lexues te rinj</b>	<b>Përpunim i librit</b>	<b>Lexus në sallën e leximit</b>
<b>127</b>	<b>128</b>	<b>8</b>	<b>0</b>	<b>0</b>